



DEGA NË LIPJAN – OGRANAK U LIPLJANU

P.nr.171/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË DEGA NË LIPJAN, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm gjykues Avdirrahman Gashi, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Nexhmije Ahmeti, duke vendosur në çështjen penale, ndaj të pandehurit Xh. Th. nga fsh. S. K.Lipjan, të cilin e akuzon PTH në Prishtinë, me aktakuzën saj PP.II.nr.7304/16 të dt. 28.02.2017, për shkak të veprës penale, Vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, në shqyrtimin fillestar publik, të mbajtur me dt.20.04.2018, në prani të përfaqësuesit të PTH-së, prokurorit E. J., dhe të pandehurit, në të njëjtën datë merr dhe publikisht shpallë këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të pandehurit:

Xh. Th., i lindur me 09.09.1970, në Lipjan, me vendbanim në fshatin S. K.Lipjan, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

Me datë 06.09.2016, është vërtetuar se në shtëpinë e tij në S. K.Lipjan, i pandehuri pa autorizimin e furnizuesit të autorizuar, është kyqur në rrjetin elektrik, pa njëisor elektrik, duke mundësuar shpenzimin e energjisë elektrike pa matje, me ç'rast i ka shkaktuar dëm KEDS-it në vlerë prej 271.50 euro,-

-me këtë ka kryer veprën penale Vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së.

Andaj gjykata konform neneve 1, 2, 4, 6, 7, 21, 41, 42, 43, 49, 50, 51, 52, 73, 320 të KPRK-së, si dhe dispozitave të nenit 365 të KPPK- së të pandehurin e gjykon me,

DËNIM ME KUSHT

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) muaji dhe me dënim me gjobë në shumë prej 200-€ (dyqind euro), të cilat dënime nuk do të ekzekutohen, nëse i pandehuri në afat prej 1 (një) viti nuk kryen veprën tjetër penale.

DETYROHET i pandehuri, që të dëmtuarës KEDS-Departamentit Ligjor në Prishtinë, t'ia kompensoj shumën e dëmit të shkaktuar në vlerë prej 271.50-€, në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

DETYROHET i pandehuri që kësaj gjykate, në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të ia paguaj shumën prej 20.€, si dhe shumën prej 30.-€, në Fondin e Mbrojtjes së Viktimave, këto në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me Aktakuzën e saj, PP.II.nr.7304/16 të dt. 28.02.2017, e ka akuzuar të pandehurin Xh. Th. , për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së.

Prokurori i shtetit në shqyrtimin fillestar, ka mbetur në tërësi pranë aktit akuzues, dhe është pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, i cili është bërë konform dispozitave ligjore dhe në përputhje me provat që gjenden në shkresat e lëndës, dhe në të njëjtën kohë gjykatës i ka propozuar që të pandehurin ta shpallë fajtor dhe ta dënoi sipas ligjit, ndërsa gjatë përcaktimit të lartësisë së dënimit për të njëjtin, nga gjykata ka kërkuar që të merret si rrethanë lehtësuese pranimi i fajësisë.

I pandehuri në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës, respektivisht për veprën penale e cila i vihet në barrë, dhe ka shtuar se disa herë i ka bërë thirrje KEDS-it për shkak të borxhit e kanë marrur një sorin elektrik edhe nuk e kanë kthyer 6 muaj apo me tepër, dhe kam qenë i detyruar ta bëj kyqjen për të siguruar rrymë, dhe njëherit nga gjykata ka kërkuar që me rastin e matjes së dënimit, të njëjtit ti shqiptohet një dënim sa më i butë, ngase i njëjti është mbajtës i vetëm i familjes, ku me punë fizike e siguroj mbajtjen e familjes, i gjendjes së vështirë ekonomike, dhe njëherit ka shprehur pendim të thellë, duke i premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do ta përsërisë veprën penale apo të ngjashme.

Gjyqtari i vetëm gjykues, i bindur se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë të vullnetshme, pranimi i fajit mbështet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, konform nenit 248 të KPPK së gjykata e pranoi pranimin e fajësisë të të pandehurit, për veprën penale të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e caktimit të llojit dhe të lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese për të pandehurin, ashtu që si rrethana lehtësuese gjykata vlerësoi rrethanat personale, pra faktin se i pandehuri është mbajtës i familjes dhe i gjendjes së dobët ekonomike, pendimin, premtimin e dhënë kësaj gjykate se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të ngjashme, e veçanërisht pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, e në mungesë të rrethanave rënduese, konform nenit 73 të KPRK-së, të njëjtit i shqiptoi dënimin e paraparë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke qenë e bindur se një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit konform nenit 50 të KPRK-së, kur vlerësohet se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit është e nevojshme të ndalojë që kryesi të mos kryejë vepër penale.

Gjykata të pandehurin në emër të paushallit gjyqësor e ka obliguar që të paguaj shumën prej 20-€, si dhe shumën prej 30.-€, në Fondin e Mbrojtjes së Viktimave, me ç'rast kishte parasysh ndërlikueshmërinë dhe kohëzgjatjen e çështjes dhe gjendjen ekonomike të t'pandehurit, konform nenit 450 par. 1 dhe par. 2 pika 6 të KPPK-së.

Vendimi mbi realizimin e kërkesës pasurore-juridike gjithashtu u bazua në dispozitën e e nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINE-DEGA NË LIPJAN.

P.nr.171/17 dt.20.04.2018

**Sekretarja juridike
Nexhmije Ahmeti**

**GJYQTARI
Avdirrahman Gashi**

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 dite nga dita e dorëzimit të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.